

I dashur Stalin...

LETËRKËMBIMI I PLOTË I FRANKLIN D. RUZVELTIT DHE JOSIF V. STALINIT

REDAKTUAR DHE PAJISUR ME SHPJEGIME NGA **SUSAN BUTLER**

PARATHËNIA NGA **ARTHUR SCHLESINGER, JR.**

Përktheu: **OLGERTA VISI**

Titulli i origjinalit: *My dear Mr. Stalin*

Copyright© 2005 by Susan Butler

All rights reserved

Copyright©

Redaktor: Sejdin CEKANI

*KUSHTUAR 405.000 AMERIKANËVE DHE 27.000.000 RUSËVE QË HUMBËN JETËN NË
LUFTËN E DYTË BOTËRORE.*

Hyrje

Për gjashtëdhjetë vjet me radhë, letërkëmbimi i kohës së luftës midis Franklin D. Ruzveltit dhe Josif Stalinit ka mbetur i paqartë. Për kohën kur u shkrua, ky letërkëmbim ka qenë tepër sekret - për të dinin vetëm Ruzveldi, Stalini dhe këshilltarët e tyre më të afërt - dhe përfshinte rreth treqind mesazhe. Dërgimi i

tyre bëhej me telegraf dhe zakonisht perifrazoheshin në atë mënyrë që të garantohej fshehtësia; herë të tjera këta burra shteti zgjidhnin titullarë të lartë, si Herri Hopkinsi, për të përçuar mesazhet e njëri-tjetrit.

Fakte të tilla rreth letërkëmbimit të tyre, nuk janë botuar ndonjëherë më të plota dhe më të sakta. Ministria sovjetike e Punëve të Jashtme, bazuar në dokumentacionin e arkivuar, në vitin 1957 nxori botimin *Letërkëmbimi i Stalinit me Atlin, Çërçillin, Ruzveltin dhe Trumanin*; i njëjti letërkëmbim ishte botuar nën titulli origjinal *Letërkëmbimi i Stalinit me Ruzveltin dhe Trumanin*, por në këtë përmbledhje mungojnë shumë nga mesazhet e Ruzveltit dhe një pjesë e mirë e letrave janë thjesht perifrazime të bëra nga Ruzvelti, dhe jo letrat e sakta. Të gjitha mbajnë datën e mbërritjes në Kremlin dhe jo datën e dërgimit.

Libri *"I DASHUR STALIN..."* është i pari që përmbledh të gjitha mesazhet origjinale të shkruara nga Ruzvelti, ndërsa ato të shkruara nga Stalini janë dhënë në formën se si Ruzvelti i lexonte dhe i kuptonte.

Çështjet e diskutuara në letërkëmbim ishin të shumëllojshme: transportimi i armatimeve, armatimet që i nevojiteshin Bashkimit Sovjetik, ndërmarrja e vendimeve strategjike për sa i përkiste luftës kundër Hitlerit dhe aleatëve të tij, mesazhet në lidhje me përparimin e luftimeve dhe datat e fillimit të pushtimeve përtej Kanalit të La Manshit, e ardhmja e Polonisë, që ishte një çështje me interes të veçantë për të dy burrat, kushtet e kapitullimit, roli dhe kompetencat e Këshillit të Sigurimit, krijimi i Asamblesë të Përgjithshme etj. Letërkëmbimi vazhdoi deri në vdekjen e papritur të Ruzveltit, në vitin 1945.

Formimi kulturor i dy udhëheqësve ishte tërësisht i ndryshëm. Ruzvelti kishte lindur në një familje të pasur, i rritur në Nju-Jork, në mes të pasurisë dhe kulturës, një fëmijë i vetëm, i përkëdhelur, i lindur në qytetin e vogël të Grotonit, në Juglindje të Konektikatit, kishte studiuar në kolegjin e Harvardit dhe në Universitetin e Kolumbias. Ai u martua me kushërirën e tij të largët, Elionor

Ruzvelt, mbesa e Presidentit Teodor Ruzvelt. Ai pati një karrierë të ngadaltë, por të suksesshme në jetën politike të vendit, kjo falë personaliteti të tij tërheqës dhe inteligjencës së pashoqe, pavarësisht vuajtjeve dhe të këqijave që kishte hequr nga poliomieliti.

Ndërkaq Stalini kishte një prejardhje tërësisht tjetër: i biri i një fshatareje dhe një këpucari që gjithë ditën e ditës pinte, sa edhe jetën e humbi në një grindje. Stalini u lind në Gjeorgji, republika që ndodhej në skajin më Jugor të BRSS, ku kaloi edhe fëmijërinë. Kur ishte fëmijë, u sëmur rëndë nga lija, shenjat e së cilës ishin lehtësisht të dallueshme në fytyrën e tij; pati një **traumë, si pasojë e septicemisë**¹ që e la edhe me krahun e majtë të paralizuar, dhe sikur këto të mos mjaftonin, pati njëfarë shtrembërimi në këmbë, çka e bënte të ecte duke u lëkundur. Student me bursë në një seminar për t'u bërë prift, u shqua për kujtesën e tij të jashtëzakonshme; u bë revolucionar, u përjashtua nga shkolla, i mbijetoi burgut dhe mërgimit. U bë edhe një nga themeluesit dhe redaktorët e gazetës *Pravda*, ku ra në sy të Leninit dhe kështu arriti të bëhej sekretari i tij i përgjithshëm në vitin 1922. Pas vdekjes së Leninit më 1924, ai ishte njëri nga shtatë anëtarët e Byrosë Politike. Më pas katër nga ata u ekzekutuan me akuzën për tradhti të lartë, pasi u detyruan të dëshmonin në të ashtuquajturin “gjyq sa për shfaqje”; një tjetër bëri vetëvrasje; dhe i fundi që provoi vdekjen e ëmbël ishte Leon Trocki, i vrarë në Meksikë në vitin 1940. Stalini e kishte udhëhequr Bashkimin Sovjetik për dymbëdhjetë vjet me radhë, që nga 1941-shi. Gjatë udhëheqjes së tij bëri kolektivizimin edhe industrializimin e BRSS-së, që për atë kohë u kthye në një superfuqi. Në mënyrë të vazhdueshme dhe me takt, zhdukuri të gjithë ata që e pengonin në rrugën e tij dhe madje nuk kurseu as miqtë e tij, kur ata

¹. Helmim i gjakut nga mikrobet. (Shënim i përkthyeses).

fuqizoheshin më tepër se ç' duhej. Të çarmatoste me përzemërsinë e tij, por ama udhëhiqte nën forcën e frikës.

Në anën tjetër, Ruzvelti ishte një burrë që dinte të të bindte dhe gati-gati të të magjepste, si dhe ndiqte politikën e mosndërhyrjes. Ishte gjithmonë në kërkim të ideve të reja dhe këshilltarëve të rinj, i pëlqente fryma e garës ndërmjet tyre dhe vendimet gjithmonë i merrte vetë. Ishte mjeshtër në bindjen e njerëzve, dinte t'i bënte të pranonin arsyetimet e tij. Si President ai ishte i vendosur t'u jepte fund marrëdhënieve armiqësore, të njihte Stalinin dhe të fitonte besimin e tij. Këtë pikësynim e arriti deri në njëfarë mase dhe ky letërkëmbim është dëshmi e largpamësisë dhe arritjeve të tij. Mesazhet e Ruzveltit tregojnë qartë se si ai arriti t'i japë formën e dëshiruar botës së pasluftës, sa i përpiktë ishte plani i tij për ta ndryshuar tërësisht qëllimin e Shteteve të Bashkuara - nga synimi i një Amerike që do të luftonte Gjermaninë dhe Japoninë, në Shtetet e Bashkuara që do bëheshin ambasadore të ruajtjes së paqes (vetë Ruzvelti ëndërronte që Amerika të mbante këtë emër).

Ndërsa mesazhet e Stalinit tregojnë qartë frikën e tij nga një Gjermani e fuqishme, këmbënguljen për të nënshtruar Poloninë, pranimin e tij me rezerva për Kombet e Bashkuara, si dhe frikën e fshehur se mos Ruzvelti dhe Çerçilli mund ta tradhtonin, ashtu si kishte vepruar edhe Hitleri; pra i druhej faktit se mos ata, veçmas, nënshkruanin marrëveshjen e paqes me Gjermaninë.

Ashtu siç mund të pritej, ky letërkëmbim duhej të ishte botuar kohë më parë, por fill pas vdekjes së Ruzveltit hija e Luftës së Ftohtë kishte kapluar botën mbarë dhe gjëja e fundit që duhej të shkruhej ishte sesi Ruzvelti kishte ndihmuar Bashkimin Sovjetik për mposhtjen e Gjermanisë.

Xhozef E. Dejvis, ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Bashkimin Sovjetik gjatë viteve 1936-1938, kishte këshilluar Ruzveltin, dhe në këtë mënyrë kishte bërë parashikimin e tij në qershor të vitit 1939 se, nëse kryeministri i Anglisë, Nevill Çambërleini, vazhdonte të ruante paqen me Gjermaninë, ndërkohë që Hitleri marshonte fitimtar nëpër Europë, “ariu plak, Stalini, do të lodhej duke u mbajtur me shpresa të kota dhe do ta vendoste, në mënyrën e tij, **paqen me Gjermaninë**”.² Ishte pikërisht ajo që ndodhi në gushtin e po atij viti: Gjermania dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruan paktin sovjeto-nazist për paqe. Në këtë mënyrë, Stalini mendoi se ishte i mbrojtur dhe vendi i tij ishte i sigurt nga Hitleri. Ndërkohë që në pranverën e vitit 1941 Gjermania filloi grumbullimin e forcave për një sulm të mundshëm, Stalini nuk donte të besonte atë që për të gjithë tashmë ishte e qartë. Nga shërbimet e fshehta në mbarë botën dhe nga vetë agjentët sovjetikë në Gjermani, vinin paralajmërime e lajme të sakta, se forcat gjermane po grumbulloheshin në kufirin sovjetik - një kërcënim për pashmangshmërinë e luftës. Megjithatë Stalini u tregua shumë mosbesues dhe **më 14 qershor urdhëroi TASS-in**³ të publikonte deklaratën e tij, ku thuhej se “Gjermania, me të njëjtën përpikëri si edhe BRSS-ja, po zbatonte kushtet e Paktit të Paqes dhe se zërat që Gjermania synonte të shkelte këtë pakt dhe të sulmonte BRSS-në ishin **të pavërteta dhe të pabazuara**”.⁴ Në mesnatën e 21 qershorit të vitit 1941, mbi tryezën e punës të Stalinit u vendos raporti i agjentëve sovjetikë në Gjermani, ku thuhej se sulmi ishte vendosur për të nesërmen. Edhe pse agjentët, që kishin rrezikuar jetën për të kaluar kufirin, e siguruan për vërtetësinë e këtij informacioni, Stalini qëndroi duarkryq, nuk veproi. Operacioni *Barbarosa* filloi në të gdhirë; kjo ishte një tronditje e paparë për burrin e vetëquajtur *Burri i Hekurt*

². Lash: *Roosevelt and Churchill*, fq 369.

³. Agjencia Telegrafike e Bashkimit Sovjetik.

⁴. Cituar në librin e Volkogonovit: *Stalini*, fq 391.

(madje e kishte ndryshuar emrin nga *Xhugashvil*, në *Stalin* - që në rusisht do të thoshte *burrë i hekurt*).

Kështu, nga fundi i korrikut, 3.600.000 gjermanë kaluan Poloninë dhe po përhapeshin si vaji në të gjithë Bashkimin Sovjetik. Hitleri tashmë kishte pushtuar Çekosllovakinë, Poloninë, Holandën, Belgjikën, Francën, Greqinë, Jugosllavinë, Danimarkën dhe Norvegjinë. Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe ndanin mendime të ndryshme përse i përkiste mbijetesës apo nënshtrimit të Bashkimit Sovjetik. Henri Stimsoni, sekretari i Luftës, i shkroi Ruzveltit një ditë pas mësymjes së gjermanëve, se “të gjithë anëtarët e kabinetit të tij ishin në një mendje: Gjermania do ta pushtonte Bashkimin Sovjetik plotësisht brenda një deri **maksimumi tre muaj**”⁵, dhe ai pajtohej tërësisht me gjykimin e tyre.

Ruzvelti, i nxitur nga fjalët e Stimsonit, u bëri një kërkesë planifikuesve të Ushtrisë dhe të Flotës Ushtarake Detare, që të përgatishnin hartën e teatrove të mundshëm të luftës dhe të përcaktonin fuqinë dhe kapacitetin që do t’u nevojiteshin Shteteve të Bashkuara në një luftë kundër Gjermanisë. Sipas sektorit të planifikimit për mobilizim, të emërtuar *Plani i Fitores*, Bashkimi Sovjetik do të tërhiqej nga lufta brenda vitit 1943. Më këtë mendim pajtohej edhe Uilliam C. Bulliti, ambasadori i parë amerikan në Bashkimin Sovjetik në vitet 1933-1936. “Nuk njoh njeri në Uashington që të besojë se Ushtria sovjetike ka mundësi t’i mposhtë gjermanët”, - i kishte komunikuar Bulliti, në muajin gusht, legjionit amerikan. Ndërsa Ruzvelti ishte më optimist. Ai i kërkoi ambasadorit sovjetik në Uashington të hartonte një listë, ku të përfshiheshin artikujt më të nevojshëm e parësorë, që t’i ndihmonte sovjetik **për mbrojtjen e atdheut të tyre**.⁶

Dy ditë pas pushtimit, Ruzvelti zhblokoi disa pasuri ruse, me një vlerë prej 39 milionë dollarësh. Katër ditë më vonë, ai hodhi në letër mendimet e tij për t’ia

⁵. Sherwood: *Roosevelt and Hopkins*, fq 303-4.

⁶. Kennedy: *Freedom from fear*, fq 486-87.

paraqitur admiralit Uilliam Lihit, ambasador në Francë. Në të vërtetë, Ruzvelti shpresonte që në atë çast Hitleri të përfshihej tërësisht në luftë, pasi ndryshimi që solli hyrja e Bashkimit Sovjetik në të ishte një faktor tepër domethënës për çlirimin e Europës nga mbizotërimi nazist; ndërkaq nuk ekzistonte aspak frika e një mbizotërimi apo hegjemonie të **mundshme sovjetike pas luftës**.⁷ Pesë javë pas pushtimit, Herri Hopkinsi - në të vërtetë alter egoja i Ruzveltit, syri dhe veshi i tij - i transmetoi Stalinit mesazhin e parë, ku e siguronte atë se Shtetet e Bashkuara do t'i vinin në ndihmë kombit të tij të rrethuar nga pushtuesi. Tre muaj pas pushtimit, pasi ushtria gjermane kishte rrethuar Moskën, Ruzvelti dërgoi në Moskë Averell Herrimenin, hartuesin e Programit të Huadhënies për Anglinë, së bashku me lord Bevrëbrukun, për të nënshkruar një marrëveshje, që u bë e njohur si Protokoll i Moskës, sipas të cilit, Shtetet e Bashkuara angazhoheshin të dërgonin në ndihmë të Bashkimit Sovjetik një miliard dollarë gjatë dymbëdhjetë muajve në vazhdim. Ishte pikërisht Herrimeni që ia transmetoi këtë mesazh të dytë Stalinit.

Po ashtu, në letërkëmbim shfaqen qartë personalitetet dhe linjat e veprimeve politike të Ruzveltit dhe Stalinit. Ruzvelti ishte i vetëdijshëm për mosbesimin dhe frikën e Stalinit ndaj të huajve, një hije dyshimi që përshkonte të gjithë shoqërinë sovjetike dhe që Ruzvelti nuk u kursye ta mposhte. Shquhet një lirshmëri e dukshme në mesazhet që Ruzvelti i dërgon Stalinit; ai është tepër miqësor. Shpesh bën përsëritje të urime, herë-herë përdor fraza mikluese duke i folur edhe në emër të Çërçillit. Me vazhdimin e luftës, Ruzvelti sa vinte edhe bëhej më i largët dhe më i ftohtë me Çërçillin dhe afrohej edhe më tepër me Stalinin, i jepte atij siguri dhe përpiquej ta qetësonte medoemos. Duke shpërfillur këshillat e shumë zyrtarëve qeveritarë, të cilët nuk e miratonin sjelljen dhe

⁷ . Lash: *Roosevelt and Churchill*, fq 364.

qëndrimin e tij për ta përkrahur Stalinin, Ruzveldi vazhdon edhe më tej me vendimin e tij për të farkëtuar një marrëdhënie midis dy shteteve, që, sipas tij, do t'i bënte ballë luftës dhe madje do të shkonte edhe më tej. Varësia e ndërsjellë midis kombeve, ishte një nga pikat thelbësore, sipas Ruzveltit. Këtë gjë ai e kishte përmendur para se të shfaqej në skenën politike.

“Civilizimi nuk mund të hedhë rrënjë të forta, nëse nuk jemi të vetëdijshëm e vigjilentë për të marrë përsipër përgjegjësitë tona e të kuptojmë se jemi të **ndërruarur nga pjesa tjetër e botës**”⁸ - kishte thënë ai.

Letërkëmbimi tregon se, edhe pse Ruzveldi po e përgatiste Amerikën për të hyrë në luftë, ai planifikonte njëkohësisht edhe paqen e pasluftës. Arthur Schlesinger, i Riu, shkruante: “Ishte pikërisht instinkti befasues dhe mahnitës që e dallonte Ruzveltin, ndjeshmëria e tij e jashtëzakonshme ndaj prirjeve të befta **që shfaqeshin në kohën e tij.**”⁹

Ruzveltin e udhëhiqte bindja se pasi të fitohej lufta, paqja do të vendosej nga “*Katër Policët*” - ai, Stalini, Çerçilli dhe Çian Kai Shia - që do t'i jepnin formën dhe do të mbikëqyrnin botën e pasluftës, sepse përfaqësonin popujt më të fuqishëm (Kina ishte vërtet një nga vendet me mundësi të jashtëzakonshme) dhe më të populluar në botë.

Për herë të parë thelbi i mendësisë së Ruzveltit u shfaq publikisht me kujdesin e tepërt që ai tregoi në renditjen e nënshkruesve të Deklaratës së Fuqive të Bashkuara (emrin e së cilës e ndryshoi ditën e fundit të vitit 1941 në: Deklarata e Kombeve të Bashkuara), sipas së cilës krijohet koalicioni i madh i vendeve që luftonin fuqitë e Boshtit. Kur përfaqësuesit e njëzet e katër vendeve u mbledhën në Shtëpinë e Bardhë për të nënshkruar deklaratën natën e Vitit të Ri 1942, ata nënshkruan sipas renditjes së vendosur nga Presidenti, shkruar me shkrimin e tij:

⁸. Cituar në librin e Sherwood: *Roosevelt and Hopkins*, fq 10.

⁹. Schlesinger: *Coming of the New Deal*, fq 587.

Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, BRSS-ja dhe Kina; pas tyre vinin vendet e tjera, sipas rendit alfabetik.

Koncepti i Ruzveltit për sistemin e tij të “Katër Policëve” mori formë reale me krijimin e Sallës së Hartave, e cila ndodhej në Shtëpinë e Bardhë dhe u krijua pak kohë pas Deklaratës së Kombeve të Bashkuara. Kjo sallë ishte ngritur nga vetë ndihmësi i Presidentit për Marinën, kapiteni Xhon L. MeKrea, më qëllimin e vetëm për të shërbyer si qendër për informimin ushtarak dhe si zyrë komunikimi për Presidentin; pra kjo ishte vetë salla e tij e luftës. Muret ishin të veshura me harta dhe skica që përditësoheshin sa herë që mbërrinin lajme të reja nga fusha e betejës. Ndodhej në katin përdhes të Shtëpisë së Bardhë dhe për të shkuar atje duhej të merrje ashensorin; pasi kaloje nëpër një korridor, pranë dhomës së mjekut, gjendej pikërisht salla në fjalë. Pasi Ruzvelti vizitonte Sallën e Hartave, nga ku njoftohej për zhvillimet më të fundit të luftës apo merrte mesazhe nga Aleatët, ai kthehej te dhoma e mjekut, ku bënte trajtimin e sinuseve, ulej për një kontroll të dhëmbëve te poltroni i instaluar posaçërisht për të ose përfitonte për t’u bërë një masazh këmbëve.

Sipas planit të hartuar nga vetë ai, Salla e Hartave ishte vendi i vetëm ku gjendeshin dosjet e plota të komunikimit të tij me Stalinin, Çerçillin, Çianin dhe qeveritë përkatëse; në të nuk mbaheshin mesazhet drejtuar vendeve të tjera apo udhëheqësve të tyre. Për t’u siguruar që as sekretari i Luftës, as komandanti i Flotës Ushtarake Detare, as sekretari i Shtetit apo shefat e Shtabit të Përbashkët të mos ishin në dijeni të rëndësisë që ai i kishte kushtuar konceptit të “Katër Policëve”, urdhëroi që mesazhet e dërguara me telegraf tre udhëheqësve të tjerë botërorë, të kalonin nëpërmjet pajisjeve të kodimit dhe të komunikimit të Departamentit të Marinës, ndërsa përgjigjet të merreshin nëpërmjet qarqeve të Departamentit të Luftës. (Të gjitha mesazhet, pa përjashtim, dërgoheshin të koduara dhe shpesh madje të perifrazuara, në mënyrë që të parandaloheshin

gjurmimi, kapja ose shkatërrimi i tyre.) Sipas Xhorxh M. Eslinit, komandant në rezervë i Forcave Detare të SHBA-ve, si dhe oficer në detyrë për shumë vite me radhë në Sallën e Hartave të Shtëpisë të Bardhë, ishte dëshira e vetë Presidentit që në Sallën e Hartave të kishte dosjet e plota të letërkëmbimit të tij vetëm me Çerçillin, **Stalinin dhe Çian Kai Shinë**.¹⁰

Ruzvelti e kishte zakon që, kur luante me letra, i mbante ato të shtrënguara pranë gjoksit. “Asnjëherë nuk i vendos mbi tryezë”, - i ankohej sekretari i Punëve të Brendshme, Herold Aiksi.¹¹

Kjo ishte *modus operandi*¹² e tij. Gjenerali Xhon R. Deini, që kishte qenë sekretar i kabinetit të Shefave të Shtabit të Përbashkët (d.m.th. atij anglo-amerikan), në vizitën e tij të vitit 1943 u mahnit kur zbuloi se anëtarët e kabinetit të Presidentit nuk e dinin përmbajtjen e mesazheve apo vendimeve të ndërmarra nga Ruzvelti dhe Çerçilli. Atij iu shpjegua se, për arsye që vetëm Presidenti i dinte, disa nga çështjet mbaheshin të fshehta derisa në to **vihej vula dhe nënshkrimi**.¹³

Hyrja në Sallën e Hartave lejohej vetëm për Leri Hopkinsin dhe admiralin Lihi, i cili pas kthimit nga Franca, në fund të pranverës së vitit 1942, u emërua shef i Shtabit të Presidentit. Përveç ekspertëve të kodifikimit, tre oficerëve të kontrollit dhe tre marinsave të Flotës Detare në detyrë, asnjë tjetër nuk kishte të drejtë hyrje në Sallën e Hartave. I vetmi përjashtim që bëhej, ishte për kryeministrin Çerçill; sa herë që ai vinte për vizitë apo vendosej në Shtëpinë e Bardhë, i lejohej të këqyrte vazhdimësinë e luftës, përshkruar më së miri nëpër hartat dhe skicat e vendosura nëpër mure; por atij nuk i lejohej vëzhgimi i dosjeve; ato ishin të kyçura.

¹⁰. Marrë nga letrat e dërguara Presidentit nga George M. Elsey, *Small Collection*, FDRL.

¹¹. Cituar nga Dallek: *Roosevelt and Foreign Policy*, vii.

¹². Nga latinishtja: mënyrë veprimi. (Shpjegim i përkthyeses) .

¹³. Deane: *Strange Alliance*, fq 9.